



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.437/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ,me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Anr.437/2025 e datës 07.02.2025.
- II. Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënim i më gjobë në lartësi prej 1,500.00 (njëmijë pesqind) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar Ankesën Anr.437/2025, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendohet se qendra e Lëvizjes se VETVENDOSJES, ka identifikuar se në tubimin e mbajtur të subjektit politik PDK, më datë 05.02.2025 në palestrën sportive “ Hysni Jetullahu” në Drenas, ka vërejtur pjesëmarrjen e fëmijëve nen moshën 15 vjeçare, pa leje dhe pranin e prindërve me këtë veprim, subjekti politik PDK, ka bërë shkelje të nenit 5, par.3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Parashtruesi i ankesës si provë, ka bashkangjitur fotografi.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka theksuar se e kundërshton në tërësi ankesën për faktin se nga fotografit e bashkangjitura si provë nuk munde te identifikohen fëmijët nen moshën 15 vjeçare, e cila vërehet edhe ne fotografin ku ne mënyrë te pakontestueshme shihen se janë fëmijët te moshës mbi 15 vjeç dhe ankuesi nuk ka mundur ta argumentoj se te njëjtë janë nen moshën 15 vjeç dhe nuk ka ofruar të cilat dëshmojnë moshën e të njëjtëve. Pa ashtu në përgjigje në ankesë theksojnë se nga rrethanat e rastit konkret dhe përmes këtyre veprimeve Subjekti në fjalë nuk është përgjegjëse për shkeljet e Rregullave te Përcaktuara ne Rregulloren Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës se Zgjedhjeve dhe Reklamimin Financiar si dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Andaj kërkojmë nga PZAP-i, qe ankesën ta hedh poshtë si të pa bazuar dhe konstatohet se me këto veprime nuk janë konsumuar shkelje te rregullave zgjedhore te përcaktuar ne Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregulloret përkatëse.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

#### Ankesë është e bazuar

Paneli ka gjetur se nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, në mënyrë të padishimtë ka konstatuar se në tubimin e mbajtur për fushatën zgjedhore të subjektit politik PDK, kanë marrë pjesë edhe fëmijët, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 5, par. 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën përcaktohet se *"Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e fëmijëve"*.

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi pretendimet e subjektit politik PDK në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, por për Panelin këto pretendime ishin të pabazuara nga se nga fotografitë e ofruara si dëshmi nga subjekti politik LVV shihet se tubimi në fjalë është i organizuar nga subjekti politik PDK, sepse shihen edhe simbolet e këtij subjekti dhe po në të njëjtën tubim kanë marrë pjesë edhe fëmijët të cilët shifen qartazi se janë nën moshën 15 vjeçare.

Andaj paneli vlerëson se veprimet tillë janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Kështu që duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *"vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tillë janë të bazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi të bazuar.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.437/2025 datë 10.02.2025

Kryesuese e Panelit  
Violeta Husaj Rugova

*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.*

